



DETYRË PROJEKTIMI – TERMA REFERENCE


**MBI HARTIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR (PMI)
PËR “QENDRAT HISTORIKE BERAT DHE GJIROKASTËR”**

- PASURI BOTËRORE NË SERI -

Shtator 2024

Pasqyra e Lëndës

1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	2
1.1 Hyrje	2
1.2 Kuadri Ligjor	2
1.3 Përfitues	3
1.4 Përshkrim i autoritetit kontraktor	3
2. HISTORIK I PËRMBLEDHUR	4
2.1 Gjirokastra	4
2.2 Berati	5
3. PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I PASURISË KULTURORE	5
3.1 Gjirokastra	5
3.2 Berati	7
3.3 Muzeumet	10
3.3.1 Gjirokastra	10
3.3.2 Berati	10
4. PROJEKTE NË PROCES	11
5. NEVOJA PËR PMI	11
6. DETYRA	13
6.1 Qëllimi dhe objektivat	13
6.2 Çështjet kyçe	14
6.3 Produkti final	14
6.4 Metodologjia	15
6.5 Gjuha	17
6.6 Vlera tavan	Error! Bookmark not defined.
6.7 Periudha e zbatimit të procesit të PMI	17
6.8 Kalendari i pagesave	Error! Bookmark not defined.
6.9 Kualifikimet minimal të nevojshme	17
7 Procedura e vlerësimit të ofertave	Error! Bookmark not defined.
8 BIBLIOGRAFI	19
9 LISTA E SHTOJCAVE	20



1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

1.1 Hyrje

Mbi një truall dinamik e plot kontraste, shkëmbor, lartësohet thajse në qendër Qendra Historike e Gjirokastrës, në një kodërz me konture të mprehta dhe në përgjithsi me rrënie të thikëta, mbi të cilën është ndërtuar kalaja, zanafilla e qytetit të Gjirokastrës dhe për gjatë shumë kohëve epiqendra kompozicionale e tij. Qyteti shtrihet mbi një terren mjaft të aksidentuar, të vendosur mbi një kodër mbizotëruese, pikë natyrshëm e përshtatshme për fortifikim ushtarak. Qyteti i Gjirokastrës mori rëndësi për shkak të vendndodhjes strategjike që mundëson kontrollin e Luginës së Drinos – një nga rrugët kryesore nga porti i Durrësit dhe Shqipëria qendrore për në Greqi dhe Bizant.

Qendra Historike e Beratit është zanafilla e qytetit të Beratit. Ajo gjendet në buzë të fushës pjellore të Myzeqesë dhe në skajin perëndimor të luginës së Lumit Osum. I njohur si “kreu i Myzeqesë”, qyteti administronte krahinën dhe kontrollonte kalimin përgjatë luginës së Osumit, njëra nga rrugët kryesore që lidhte ultësirën bregdetare me zonën e brendshme malore.¹

1.2 Kuadri Ligjor

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 172 më 2 qershor të vitit 1961 Berati dhe Gjirokastra së bashku me Pazarin e vjetër në Krujë dhe nëntokën e Durrësit janë ansamblet e para urbane që u vendosën në mbrojtje shtetërore. Zonifikimi i qytetit të Beratit dhe rregullorja përkatëse, morën forcë vepruese me dy vendimet e Këshillit të Ministrave, të cilat shpallnin Beratin qytet-muze vendim 172 dhe aprovonin rregulloren mbi administrimin e qytetit vendim nr. 170, datë 2 qershor 1961, e cila shoqërohej edhe me planin e zonifikimit të qytetit.

Parimet e vlerësimit të qytetit muze të Beratit kanë qenë në bazën e veprimtarisë së mëtejshme për vënien në mbrojtje të qytetit muze të Gjirokastrës, nëpërmjet ligjit Nr.1886, datë 10.06.1973 ku u miratua rregullorja mbi mbrojtjen, restaurimin dhe administrimin e qytetit-muze të Gjirokastrës. Gjithashtu ka shërbyer si bazë për vënien në mbrojtje dhe të qendrave historike, apo ansambleve në Korçë, Shkodër, Elbasan, Vlorë e Tiranë, etj.²


Për vlerat e spikatura universale që mbart, Qendra historike e Gjirokastrës u regjistrua në Listën e Trashëgimisë Botërore në vitin 2005. Në vitin 2008 pasuria botërore zgjerohet duke përfshirë edhe Qendrën Historike të Beratit si pasuri botërore në seri. Si një pasuri e vetme në Listën e trashëgimisë Botërore, të dy qendrat historike ruhen si “shembuj të rrallë të qyteteve të periudhës osmane të ruajtur mirë” në Ballkan. Ato mbrohen në bazë të kriterëve kulturore III dhe IV të Udhëzuesit Operacional si më poshtë:

Kriteri (iii): Berati dhe Gjirokastra japin dëshmi të jashtëzakonshme për diversitetin e shoqërive urbane në Ballkan dhe për mënyrat e gjata të jetesës që sot pothuajse janë zhdukur. Urbanistika dhe banesat e Gjirokastrës janë ato të një qyteti kalaje të ndërtuar nga pronarë të shquar tokash, interesat e të cilëve ishin të lidhur drejtpërdrejt me ato të pushtetit qendror. Berati mban gjurmën e një stili jetese më të pavarur, i lidhur me funksionet e tij artizanale dhe tregtare.

Kriteri (iv): Së bashku, dy qytetet e Gjirokastrës dhe Beratit japin dëshmi të jashtëzakonshme për lloje të ndryshme monumentesh dhe banesash urbane popullore gjatë periudhës klasike osmane,

¹ Baçe, Apollon; “Qyteti i fortifikuar i Beratit”; Monumentet 1971/2

² Riza, Emin; “Qyteti muze i Beratit, arritje dhe perspektiva”; Monumentet 1990 /2



në vazhdimësi me kulturat e ndryshme mesjetare që i paraprinë dhe në një gjendje bashkëjetese paqësore me një pakicë të madhe të krishterë, veçanërisht në Berat.³

Qendrat historike të Gjirokastrës dhe Beratit mbrohen nga Ligji mbi Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë Nr.27/2018, dhe aktet nënigjore të tij përkatësisht:

- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 827, datë 28.12.2023 për “deklarimin si pasuri kulturore e paluajtshme “qendër historike” të një zone në qytetin-muze të Beratit, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 764, datë 20.12.2023 për “deklarimin si pasuri kulturore e paluajtshme “qendër historike” të një zone në qytetin-muze të Gjirokastrës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”

Gjithashtu këto dy qendra historike mbrohen në bazë të Konventës së Trashëgimisë Botërore 1972 nëpërmjet statusit ndërkombëtar si pasuri botërore në seri (2005, 2008).

Brenda kufirit të zonifikimit “Qendër Historike dhe Zonë e Mbrojtur” në Gjirokastrë kanë status të veçantë mbrojtjeje ligjore rreth **69 Monumente të kategorisë së parë dhe 323 monumente të kategorisë së dytë.**

Brenda kufirit të zonifikimit “Qendër Historike dhe Zonë e Mbrojtur” në Berat kanë status të veçantë mbrojtjeje ligjore rreth **87 Monumente të kategorisë së parë dhe 360 monumente të kategorisë së dytë.**

Kuadri i përgjithshëm i planifikimit dhe zhvillimit të territoreve brenda të cilëve gjenden Qendrat Historike Berat dhe Gjirokastrë përbëhet nga dy ligje me një rëndësi të vecantë, përkatësisht Ligji Nr. 139/2015 “për Vetëqeverisjen Vendore” si dhe Ligji Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.

Planet e Përgjithshme Urbanistike të Bashkive Berat dhe Gjirokastrë janë të plota dhe të miratuara në KKT përkatësisht: PPV Berat më 29.12.2016 dhe PPV Gjirokastrë më dt. 08.02.2017.

Shtojca Nr.1 dhe Shtojca Nr.2 paraqesin kufijtë e zonifikimeve të dy qendrave historike dhe zonave të mbrojtura të tyre, si dhe listën e pasurive kulturore të ruajtura brenda kufijve të zonifikimeve.

1.3 Përfitues

Përfitues të këtij projekti do të jenë MEKI, IKTK-ja, DRTK Gjirokastrë, DRTK Berat, Bashkia Gjirokastrë dhe Bashkia Berat.


1.4 Përshkrim i autoritetit kontraktor

Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) është autoriteti kontraktor i cili ka përgatitur termat e referencës për zhvillimin e këtij Plani të Integruar të Menaxhimit.

Misioni i IKTK:

Detyra themelore e **IKTK-së** është ruajtja, mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe vlerësimi i monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë. IKTK-ja ndërton të gjithë punën kërkimore-shkencore, ndjek zbatimin e legjislacionit

³ Faqe zyrtare e UNESCO-s, <https://ehc.unesco.org/en/list/569>



kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e trashëgimisë kulturore, kryen, mbikëqyr dhe kolaudon veprime konkrete mbi monumentet e paluajtshme dhe objektet e luajtshme, pjesë integrale e tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, bën kualifikimin e kuadrit, autorizon, si dhe përcakton kriteret e restaurimit.

Në funksion të përmbushjes së Misionit të tij, IKTK-ja merr të gjitha masat që sigurojnë gjurmimin, hulumtimin, mbrojtjen, dokumentimin e plotë, konservimin, restaurimin shkencor dhe promovimin e monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore. IKTK-ja, aktivitetin e saj e kryen në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, të cilat, bazuar në Ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" veprojnë nën koordinimin dhe mbikëqyrjen e saj.

2. HISTORIK I PËRMBLEDHUR

2.1 Gjirokastra

Gjirokastra i ka fillimet e veta nga një kala ushtarake dhe administrative të shekullit të XIII. Ndryshe nga shumë qytete të tjera të Ballkanit, qyteti nuk ka qenë qendër zejtarie që në fillimet e veta, por qendër ku jetonin pronarë shqiptarë të mëdhenj tokash, si dhe zyrtarë të Perandorisë Osmane; kjo gjë që ndikoi si në karakterin e qytetit, ashtu edhe të banesave të tij. Njohimi i parë i njohur mbi qënien e Gjirokastrës na vjen në vitin 1336 nga kronisti J. Kantakuzeni, i cili ndër të tjera përmend kryengritjen e arbëreshëve kundër Bizantit. Ky autor e përmend Gjirokastrën dy herë si "Argyrokastron", qytet e pastaj kështjellë.

Në shekullin XIII, Gjirokastra dhe rajonet përreth saj u sunduan nga familja e Gjin Zenebishit. Perandoria Osmane që u shtri në Europë në fund të shekullit XIV, e përfshiu Gjirokastrën nën sundimin e vet në vitin 1419, sundim që zgjati deri në vitin 1912, pothuajse 500 vjet. Në këtë kohë qyteti kishte 163 banesa. Ai lulëzoi si kryeqyteti i Sanxhakut (njësi administrative osmane) shqiptar për më shumë se një shekull, derisa u zëvendësua nga Delvina gjatë regjimit të Sulltan Sulejmanit të Madhërishtëm (1520-1566).

Në fillim të shekullit XV ka ekzistuar një lagje e banuar jashtë mureve të kalasë si dhe pazari i qytetit, të cilin e përmend Celebiu me emërtimin "Pazari i Kalasë", pikërisht aty ku sot ndodhet toponimi "Pazari i vjetër". Zgjerimi i qytetit jashtë mureve të kalasë në bazë të të dhënave në defterin turk dhe hipotezave të bazuara duhet të ketë ndodhur ndërmjet shek. XIV-XVI.

Gjirokastra luante rol administrativ si seli e kadiut (gjyqtar); me vendndodhjen strategjike e rrethinat e pasura, qyteti mbeti i rëndësishëm dhe në vitin 1583 e dyfishoi numrin e popullatës paraosmane. Ai përjetoi rritje të mëtejshme në shekullin XVII, kohë kur ishte zgjeruar pothuajse sa qyteti historik i tanishëm dhe u përcaktuan parimet e kompozimit të tij urban.

Nga të dhënat e Celebiut mund të pohohet se Gjirokastra rreth cerekut të tretë të shekullit XVII kishte arritur thuajse shtrirjen e sotme, natyrisht me një dendësi të rrallë ndërtimesh. Vetëkuptohet se kështu ishin trasuar dhe linjat kryesore të kompozimit urbanistik të qytetit.

Ali Pashë Tepelena e mori Gjirokastrën në vitin 1811. Lindur pranë qytetit të vogël të Tepelenës në vitin 1744, ai i ngjiti shkallët nga kryetar çete banditësh në guvernator rajonal – Pasha të Epirit. Nën sundimin e Ali Pashës, Gjirokastra u bë bastion strategjik dhe tregtar mes dy kryeqyteteve të tij binjake Tepelenës dhe Janinës, duke hedhur kështu themelet e pasurisë së saj. Gjirokastra u zhvillua si kurrë më parë dhe ishte kjo periudha kur u ndërtuan shtëpitë e para të mëdha, të cilat i dhanë qytetit pamjen karakteristike që ruan edhe sot. Gjithsesi, ambicia e tij për t'u fortifikuar sa të ishte gjendje t'i kundërvihej Perandorisë Osmane dështoi, kur Sulltan Mahmuti II e përmbysi



dhe e ekzekutoi në Janinë në vitin 1822. Pasi vrasjes së Ali Pashës, qyteti vazhdoi të zhvillohej si qendër administrative osmane dhe qendër tregtare e bujqësore.⁴

2.2 Berati

Historia e Beratit si qendër e banuar zë fill në lashtësi rreth viteve 2600 p.e.s., siç tregojnë dëshmitë arkeologjike. Më pas, qendër paraqytetare me rrethimin e saj prej muresh të fuqishme në shek. IV p.e.s. fillon historia e njërit prej qyteteve të rëndësishme ilire, me jetë urbane të pasur e thuajse të pandërprerë. Furia shkatërruese romake në vitin 200 p.e.s. si hakmarrje ndaj qëndresës pati për objekt si muret rrethuese ashtu edhe jetën njerëzore, u shlye relativisht shpejt. Gjatë antikitetit të vonë, në shekujt IV- VI, rëndësia e qytetit rritet.

Mesjeta, kalohet nga kjo qendër me ngjarje të rëndësishme pushtimesh e qëndresash. Ajo përfshihet në suaza të ndryshme shtetërore, ku rolin parësor e luajti perandoria bizantine. Më 1417 Berati pushtohet nga osmanët, për t'u përfshirë pas 5 shekujsh në suazën natyrale të shtetit të porsakrijuar shqiptar.

Ndryshimet politiko- shoqërore, ndërrimet e emrave Antipatria (mendimi tradicional) Pulheriopolis, Belgrad e Berat, në rrjedhën e gjatë disashekullore të kësaj qendre, nuk ndryshuan thelbin e tipareve etniko-kulturore të banorëve të saj, gjithë duke u përfshirë ata aktivisht në evolucionin e kontekstit historiko-shoqëror, siç dëshmohet edhe nga monumentet e periudhave të ndryshme. Këta i përkasin shumë gjinive, duke filluar prej kalasë, ndërtimeve të kultit, mjaft prej të cilave me pasuri të mëdha arti, e së fundi vlerave të rralla në fushën e arkitekturës popullore.⁵

3. PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I PASURISË KULTURORE

Qendrat Historike Gjirokastrë dhe Beratit janë dëshmi e gjalla të vlerave të trashëgimisë urbanistiko-arkitekturore shqiptare.

3.1 Gjirokastra

Përbërësit kryesorë Qendrës Historike Gjirokastrë janë:


- Kalaja, e cila shërbente si pallat për sunduesin dhe si fortifikim ushtarak.
- Pazari, si zona për zejтари dhe tregti.
- Monumentet e Kultit (kishat, xhamitë dhe teqetë).
- Lagjet e banuara – arkitektura tradicionale.

Kalaja

Pozita e kalasë kundrejt lagjeve të banuara ka ruajtur gjithmonë rol të dorës së parë në pamjen e qytetit, ndërsa roli funksional i saj bie ndjeshëm duke filluar rreth gjysmës së dytë të shek XIX. Mendimi i sotëm për kohën e ndërtimit të kalasë së Gjirokastrës, bazuar mbi burimet e njohura dhe të dhënat që ofron ndërtimi, e vendos atë në gjysmën e shek. XIII. Kalaja mbetet dhe sot po aq potente kundrejt territorit për vetë pozicionin e saj dominant dhe lartësisë dhe madhësisë së mureve. Është padyshim pikë e cila vizitohet jo vetëm nga turistët por shërben prej vitesh si pika e takimit të festivaleve të folklorit.

⁴ Doempke S., Lulo A., Petrela S.; "Katër qytete historike në Ballkanin Jugperëndimor"; GCDO; Tiranë; 2012

⁵ Riza, Emin; "Qyteti muze i Beratit, arritje dhe perspektiva"; Monumentet 1990/2



Ansambli i Pazarit

Fillimisht ai u shtri në kreshtën jashtë portës veriore të kalasë, një zonë që njihet ende si Pazar i Vjetër. Në vitet 1580⁶ qyteti kishte më shumë se 400 banesa dhe ishte bërë qendër tregtie, që i shtojë rëndësisë së saj administrative. Në shekullin e 17-të, guvernatori osman Memi Pasha, planifikoi dhe ndërtoi një qendër të re tregtare për Gjirokastrën përgjatë shpatit perëndimor të kodrës, Pazarin e Ri, (më tej të përmendet thjesht si Pazar). Ai shtrihet nga një pikë lidhjeje qendrore, e ashtu-quajtura “Qafa e Pazarit” në pikëtakimin e pesë rrugëve, të cilat e lidhin atë me lagjet e banuara në të gjitha drejtimet dhe përfshinte një xhami të ndërtuar veçanërisht për t’i shërbyer zejtarëve të pazarit. “Qafa” është akoma qendra e qytetit historik.

Pazarit u shkatërrua pothuajse plotësisht nga zjarri dhe u rindërtua në vitet 1750⁷. Pas një zjarri tjetër shkatërrues në shekullin e 19-të, ai u rindërtua përsëri. Rrugët e tij, duke ruajtur akset e vjetra, u zgjeruan dhe shtëpitë që u ndërtuan në këtë periudhë janë ato që ekzistojnë edhe sot. Në periudhën e vet të lulëzimit në fillimin e shekullit të 20-të, pazari i Gjirokastrës kishte rreth 410 punishte dhe ishte një qendër zejtarie për gjithë Shqipërinë e jugut.⁶

Kisha e Shën Sotirës

Shën Sotira ndodhet në skajin më verior të kalasë, në Lagjen Pazar i Vjetër. U ndërtua në vitin 1784 dhe ka një projektim tipik ortodoks – me formë drejtkëndëshe dhe orientim sipas boshtit lindje-perëndim. Kisha quhet gjithashtu Mitropolia e Vjetër, pasi dikur ishte selia e peshkopit ortodoks lokal. Shën Sotira është një kishë e llojit bazilikë me tre nefe. Hapësira e brendshme përbëhet nga narteksi, ekzonarteksi dhe altari. Nefi kryesor i gjerë dhe dy nefet anësore më të ngushta mbulohen nga harqe cilindrike. Në pjesën e altarit, ka tre absida. Më vonë në hyrjen e kishës u shtua kambanorja.

Xhamia e Pazarit


Xhamia e pazarit është e vetmja xhami që ka mbetur nga 15 xhamitë në Gjirokastrë. Asnjë nuk e di saktësisht përse kjo xhami u kursye. Pas vitit 1967, ndërtesa, me tavanin e vet të lartë në formë kupole, u përdor si cirk për akrobatët. Me fundin e regjimit komunist, xhamia është rikonstruktuar. Xhamia ishte pjesë e planit fillestar të Memi Pashës në shekullin e 17-të për Pazarin. Ajo u shkatërrua nga një zjarr në shekullin e 18-të, dhe u rindërtua rreth viteve 1754-1755, së bashku me pjesën tjetër të pazarit. Xhamia u projektua qëllimisht që të shtrihej deri tek balli i rrugës, duke krijuar një paradë të vogël dyqanesh të mbyllura, të cilat u dhanë me qira për të siguruar fonde për mirëmbajtjen e xhamisë. Deri edhe sot, komuniteti mysliman është pronari më i madh i ndërtesave në pazar. Së fundmi xhamia është restauruar falë investimit të TIKA dhe nën mbikëqyrjen e IKTK-së.

Xhamia në Meçite, Shtatë Krojet dhe Hamami

Kompleksi i xhamisë, hamamit dhe shtatë krojet në fund të një përroske, të njohura së bashku si “Shtatë Krojet”, ka qenë qendra sociale e një lagjeje të quajtur Meçite dhe një nga hapësirat e pakta publike të hapura të Gjirokastrës. Krojet u ndërtuan në themelet e xhamisë Meçite të shekullit XVII. Rrënojat e kullës së minares ndodhen menjëherë në të djathtë të 48 krojeve. Xhamia, e njohur për çatinë e saj me dekorim të fisëm, dikur arrihej nëpërmjet shkallëve të ndërtuara mbi kroje. Ajo u shkatërrua në vitin 1967, gjatë fushatës antifetare dhe që atëherë, ndërtesa e ka humbur funksionin e saj social. Burimet ujore në këtë vend janë gjë e veçantë për Gjirokastrën dhe mund të ketë qenë arsyeja fillestare, që është zgjedhur ky vend për të ndërtuar një kult fetar. Krojet vazhdojnë të ekzistojnë dhe në ballinën e kroit qendror është gdhendur një mbishkrim i bukur osman.

Teqeja

⁶ Doempke S., Lulo A., Petrela S., “Katër qytete historike në Ballkanin Jugperëndimor”; GCDQ; Tiranë; 2012



Datuar në shekullin e 17-të ose më përpara, Teqeja e Kodrës së Shtutit, në anën e kundërt të qytetit, ishte qendër tjetër kryesore e Urdhrit Sufi të Bektashinjve. Mund të shihen aty rrënojat e shtatë tyrbeve. Tyrbja kryesore, në majë fare të kodrës, përmban varret e tre dervishëve të rëndësishëm.

Arkitektura e traditës

Banesa gjirokastrite, me tiparet e saj të spikatur dhe arritjet e shënuara si në planin kompozicional edhe në atë të trajtimit të elementëve arkitektonik – konstruktiv, zë një pozitë të veçantë në tipologjinë e banesës qytetare shqiptare.

Zhvillimi i saj lidhet me periudha relativisht të largëta dhe përfundon rreth fundit të shek. XIX. Tipologjia e banesës kushtëzohet përgjithësisht nga një tërësi faktorësh që lidhen me mënyrën e jetesës së banorëve, shkallën e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, klimën, hapësirën, materialet ndërtimore, traditën, karakteristikat e truallit të ndërtimit, etj.

Elementi kryesor që formon qytetin është banesa, e cila përbën jo vetëm masën e kompozimit, por me karakterin e saj të fortë monumental, krijon theksime të goditura brenda unitetit të larmishëm të krejt qytetit. Gjirokastra shquhet për një origjinalitet që shprehet si në tipin e banesës ashtu dhe në tipin e vetë qytetit. Banesa e fortifikuar ka qenë dominuese në qytetin e Gjirokastrës deri nga fundi i shek XIX, kohë në të cilën banesa gjirokastrite humbet karakterin e saj mbrojtës.

Në gjendjen e sotme, Gjirokastra ruan ansamble dhe lagje, që i përkasin periudhës prej fundit të shek. XVII e deri në fillim të shek. XX. Banesa e fortifikuar gjirokastrite edhe pse ka analogji të forta me banesat e qyteteve të tjera shqiptare si Berati e Shkodra, ka një rrugë zhvillimi të sajën, prandaj dhe mund të flitet për banesën gjirokastrite në kuptimin e një tipi të veçantë të banesës shqiptare. Terreni i pjerrët ka influencuar në mënyrë të ndjeshme në kompozimin e banesës gjirokastrite që në tipin primar i cili është vendosur normal me vijat rrushkulluese.⁷

Në saj të këtyre faktorëve, banesa gjirokastrite shfaqet në mbarë kompozimet e saj në tri variante kryesore:

1. perpendikulari, që është më i thjeshti dhe më i hershmi, deri tek variantet më të zhvilluara, Ky tip i quajtur perpendikular (G. Strazimiri) është banesë e thjeshtë dy-katëshe dhe më vonë zhvillohet dhe tre-katëshe e ndërtuar krejtësisht me muraturë guri. 2. me një krah dhe 3. dy krahë, të cilët janë më të vonë.

Këto tipa vazhduan të ndërtohen, duke u bërë shprehëse dhe një nga dëshmitë kryesore të hierarkisë shoqërore të kësaj qendre.


Një nga tiparet më përfaqësuese të banesës gjirokastrite në përgjithësi është karakteri mbrojtës i saj, i cili është vënë në dukje nga një numër studiuesish si A: Psalidha, G. Han, M. Shuflaj, J. Burkard, L. Rei, A. Baldaci, B. Kolev.

Për shkak të kësaj vetie mbrojtëse, studiues si E. Riza, kanë propozuar termin “banesë e fortifikuar”, kundrejt “kullë qytetare”, të propozuar nga etnografi Rr. Zojzi, për të dalluar këtë kategori ndërtimore prej shumësisë së ndërtimeve të emërtuar “kullë”.

3.2 Berati

Fillimet e jetës i përkasin epokës së bronzit, ndërsa shekulli IV para erës sonë i përket kthimit nga një vendbanim paraurban në një qendër urbane të pajisur me mure mbrojtëse. Kalaja me muret e saj ndoqi vazhdimisht rrjedhën e ngjarjeve historike, si pjesë e vetë historisë, gjatë ekzistencës së saj 2400-vjeçare ka përjetuar disa zgjerime, shkatërrime dhe rindërtime. Gjatë rindërtimeve u përdorën teknikat e kohës, të ndikuara përgjithësisht nga evolucionet e teknikave ushtarake. Muret e kalasë pasqyrojnë gjurmë nga periudhat kryesore të zhvillimit të qytetit: Periudha Ilire, Periudha Bizantine, Periudha e principatave feudale shqiptare, Periudha e hershme e pushtimit turk, Periudha e Pashallëqeve të Mëdhenj Shqiptarë.

⁷ Riza, Emin; “Banesa e fortifikuar Gjirokastrite”; Monumentet 1971/1



Përbërësit kryesorë të Qendrës Historike Berat janë:

- Kalaja.
- Monumentet e kultit (kishat, xhamitë dhe teqetë).
- Lagjet e banuara – Arkitektura e traditës.

Kalaja, zanafilla e qytetit, paraqet një mozaik duarshfazash ndërtimi. Faza e parë ilire e shekullit IV p.e.s. ndërtuar me mure të fuqishme prej gurësh të latuar, prej të cilave ruhen mjaft trakte, përcaktoi linjën e mureve rrethuese, e cila thuhet nuk ndryshoi për 22 shekuj me rradhë. Shpesh për rindërtimet janë ripërdorur gurët gëlqeror antikë. Shekullit XIII, i takon ndërtimi i oborrit i fortifikuar, përpara hyrjes kryesore. Po kësaj kohe i përket edhe ndërtimi i kështjellës, muret e së cilës përforcohen me gjashtë kulla. Në një kohë të dytë u veçua pjesa juglindore, e cila u kthye në kështjellë të brendshme, seli e parisë së qytetit. Më vonë, me disa rindërtime të Ali Pashë Tepelenës, në fillim të shekullit XIX, kalaja pëson zgjerim e rindërtime.

Në gjendjen aktuale, fortifikimi paraqitet kryesisht me një arkitekturë bizantine-osmane të murit rrethues, me 24 kulla e 5 hyrje dhe pak gjurmë nga faza e parë antike. Porta kryesore, e vendosur në anën veriore me një oborr të fortifikuar me korridor, i përket një rikonstruksioni të fillimit të shekullit të 13-të, periudhë kur kalaja drejtohej nga despoti i Epirit, Mikael Komneni, i cili ka vulosur gjurmët e tij në muret e kështjellës. Në majë të kodrës ngrihet një tjetër fortifikim (shek. XIII), kalaja e garnizonit (akropoli II), e pajisur me dy hyrje, e cila shërbente si strehë për garnizonin dhe fisnikërinë në rast të marrjes së brezit të fortifikimit të parë.

Kalaja e Beratit e ndërtuar në të djathtë të lumit Osum, në majë të një kodre të pjerrët në 187 m nivelin e detit, ishte një pikë strategjike mbrojtjeje. Kalaja është e përzier organikisht me kodrën shkëmbore si dëshmi i jetës së pandërprerë urbane që nga shekulli IV para Krishtit – një qytet 2400 vjeçar. Mënyra të jetesës që sot pothuajse janë zhdukur. Berati pati një periudhë të gjatë pushtimesh dhe tolerancash fetare në të njëjtën kohë.

- Jeta e qytetit filloi si një vendbanim ilir dhe më vonë, në shekullin III p.e.s., u kthye në një qytet kështjellë të njohur si "Antipatrea".
- Shekulli II p.e.s., romakët e quajtën qytetin "Albanorum Opidum" (kalaja e Arbërit). Nga shekulli V-IX qyteti mbante emrin "Pulheriopolis" dhe ishte një qendër peshkopale.
- Në gjysmën e parë të shekullit të 6-të, në listën e fortifikimeve të Justinianit gjendet me emrin "Antipagrai".
- Gjatë pushtimit bullgar që zgjati rreth 150 vjet, shekulli IX – XI, qyteti mori emrin "Belgrad" (qytet i bardhë), prej nga vjen emri aktual "Berat".
- Në fillim të shekullit të XIII, fortifikimi pësoi një rimëkëmbje të përgjithshme, të kryer nga Mikael Komneni, Despoti i Epirit, i cili përfshinte disa kulla dhe pjesë muresh.
- Kalaja u zgjerua më pas, veçanërisht gjatë principatave feudale shqiptare – sundimi feudal i familjes Muzakaj. Brenda kalasë, shek. XIII-XIV, ndërtuan kisha me afreske dhe ikona të vlefshme, si dhe një shkollë ikonografike.
- Gjatë periudhës së hershme osmane, shek.
- Pas pushtimit turk, Berati qëndroi nën patriarkanën e Ohrit deri në vitin 1767. Gjatë periudhës osmane u ndërtuan kisha të reja jo vetëm brenda Kalasë por edhe jashtë saj.
- Veprimtaria e fundit rindërtuese në Kala daton në shekullin e XVIII, periudhë e pashallëqeve të mëdha shqiptare. Ahmet Kurt Pasha rindërtonte kështjellën në 1768.



Monumentet e kultit, janë të shumta në Berat. Në gjendjen e sotme vetëm disa fragmente dëshmojnë për ndërtime të periudhës paleokristiane. Nga ndërtimet më të hershme që i përkasin shekujve XIII- XIV, përmendim treshen e mirënjohur të kishave të Shën Mëri Vllahernës dhe Shën Triadhës, brenda mureve rrethuese të kalasë, si dhe atë të Shën Mëhillit, ngritur mbi pjerrësinë e thepisur shkëmbore jugore, e cila ishte përfshirë brenda fortifikimit me dy muret anësore të shekullit XIII. Të tipit kryq të brendashkruar, ato me dinamizmin e theksuar dhe dekorin qeramoplastik përfshihen në tipologjinë bashkëkohore. Pas një pauze që lidhet me pushtimin turk, veprimtaria ndërtuese e kishave vazhdon, tashmë duke parapëlqyer tipin bailikal, si dhe kapelat e thjeshta. Veçanërisht e dendur që veprimtaria ndërtuese dhe rindërtuese në kishat e kalasë. Krahas ndërtimeve me përmasa e formulim modest të pamjeve të jashtme, gjatë shekujve XVII- XVIII ndërtohen, apo rindërtohen edhe kisha krahasimisht të mëdha si ajo e Vangjelizmoit dhe Katedralja e Shën Mërisë, të dyja në Kala. Pushtimi turk pruri një repertor të ri edhe në ndërtimet e kultit të Beratit. Xhamia dhe teqetë, janë të shumta dhe me vlerë. Ndërtimet e para të xhamive i përkasin shekullit XV. Ato i takojnë tipit me salla mbuluar me çati, dhe duke filluar nga shekulli XVII dhe atij me sallë me kupol. Ndër xhamitë e Beratit vlera të veçanta kanë rrënojat e së ashtuquajturës “xhamia e kuqe” shek. XV, rrënojat e xhamisë Mbret, po të kësaj kohe dhe të rindërtuara në shek. XVIII- XIX, e xhamisë së Plumbit (1553- 54), një nga ndërtimet më të goditura të kësaj gjinie, si dhe xhamisë së Beqarëve, (1827), e ndikuar në kompozimin e saj nga trualli i pjerrët, ashtu si dhe ndërtimi i banesës. Ndër teqetë e Beratit, një vend të veçantë zë ajo e Helvetive, një realizim me vlera të veçanta në sferën e ndërtimeve tona islamike, ndërtuar në vitin 1782. Ndërtimet e kultit dhe veçanërisht ato të kultit kristian, dallohen për pasurinë e madhe të vlerave artistike në pikturën murale, atë të kavaletit, si dhe në punimet e drurit. Eksterieri i varfër është në kontrast të spikatur me pasurinë e madhe të brendësisë së kishave të shekujve XVI- XIX. Emrat tashmë të shquar të piktorëve tanë mesjetarë të Onufrit, të birit të tij, Nikollës, krahas anonimëve të tjerë, lidhen ngushtas me Beratin. Ata punuan si në gjininë e pikturës murale dhe në atë të kavaletit, me arritje ku spikat individualiteti krijues dhe kultura e gjerë artistike. Daltimi në dru, siç shihet në ikonostasin e katedrales, ka hyrë gjatë shekujve XVIII- XIX në fushën e krijimtarisë artistike.

Qyteti i Beratit krahas vlerave të rëndësishme në fushën e ndërtimeve mbrojtëse dhe atyre të kultit, ruan një pasuri të madhe e të çmuar në gjininë e **arkitekturës popullore**, në këtë rast sinonim i banesës popullore. Për vlerat dhe numrin krahasimisht të lartë të shembujve të ndërtimeve popullore ai mund të krahasohet vetëm me Gjirokastrën duke qenë kështu së bashku si pasuri botërore në seri.

Ashtu si në Gjirokastrë dhe në Berat ruhen ansamble të plota ndërtimesh popullore kryesisht të shekujve 18-19. Është e kuptueshme se zgjedhjet urbanistike si ansamble paraqesin vlera më të qëndrueshme e jetëgjata, ndërsa banesa si kategori themelore e ndërtimeve popullore paraqet një prirje dinamike e cila ka rritme të ndryshme në përputhje me kushtet ekonomike-shoqërore të kohës. Interpretimi korrekt i kësaj pasurie të vërtetë dokumentare të çon natyrshëm në përcaktimin e karakterit dhe tipareve të shoqërisë së kohës në hapësirat ku është ndërtuar kjo kategori ndërtimore.

Krijimtari, që formulon tërësinë e qytetit- muze, ajo i përket në planin ndërtimor kryesisht shekujve XVIII- XIX, pa përjashtuar nëndërtimet më të hershme. Ashtu si përgjithësisht, formulimi urbanistik i ansamblit të lagjeve të vjetra të Beratit është më i hershëm. Ansamblet kompakte të tij me kompozimet racionale e njëherazi spontane në lirizmin e tyre, përfshihen ndër shembujt më të goditur të arkitekturës sonë popullore. Lidhja e përsosur me truallin, silueti dinamik, kompaktësia e theksuar dhe harmonia e arritur, karakterizojnë lagjet e Beratit, vërtet me tipare specifike, por në lidhje organike për të formuar njësinë urbane. Larmia e theksuar tipologjike e banesave brenda repertorëve disi të kufizuar programorë, kanë lënë hapësira të gjera interpretimesh për koncepte të



ngulitura kompozicionale, duke mos i lënë krijimeve asnjë shenjë monotone megjithëse brenda kufijsh normativë, madje qartësisht të përcaktuar.⁸

Për tu theksuar është dhe larmia e madhe tipologjike e ndërtimeve popullore të Beratit si dhe zgjidhjet po aq të veçanta në planin urbanistik. Krijuesit e këtij qyteti, mjeshtërit e talentuar shqiptarë, në kuadrin e një bagazhi të gjerë njohurish profesionale të trashëguara brez pas brezi, nuk janë treguar përsëritës të ngurtësuar zgjidhjesh gjerësisht të njohura. Ata në çdo rast veçanërisht në zgjidhjet urbanistike dhe arkitektonike në troje të pjerrëta kanë treguar një ndjenjë të shëndoshë krijuese dhe praktikizëm, duke i dhënë zgjidhje problemeve që krijojnë padyshim pjekuri e fuqi krijuese.

3.3 Muzeumet

3.3.1 Gjirokastra

Muzeu Kombëtar i Armëve

I hapur në vitin 1971, ndodhet aty ku dikur ishte një pjesë e burgut të ndërtuar nga italianët në majën e kullës më të madhe të kalasë. Janë të ekspozuara armët shqiptare të përdorura gjatë luftërave për pavarësi të vitit 1912 dhe 1920, si dhe armët e përdorura nga partizanët shqiptarë dhe trofetë nga Lufta II Botërore. Në muze është përfshirë edhe një përzgjedhje e vogël pikturash të realizmit socialist në Shqipëri, pjesë e një koleksioni shumë më të gjerë.

Muzeu i Gjirokastrës.

Është vendosur në një nga galeritë e Kalasë. Ai është i pari i llojit të tij që mbart një shpjegim të historisë së qytetit dhe rajonit përreth, si dhe portretizon disa nga personalitet më të rëndësishme të historisë. Në vitrinat e tij janë paraqitur edhe objekte arkeologjike, sidomos nga gërmimet e fundit në Adrianopol, armë nga periudha otomane dhe objekte të tjera nga periudha komuniste.

Muzeu Etnografik i Gjirokastrës

Ndodhet në vendin ku dikur ishte shtëpia e fëmijërisë së Enver Hoxhës, diktatorit komunist të Shqipërisë nga viti 1944 deri në vitin 1985. Ndërtesa e muzeut u ndërtua në vitin 1966, pasi shtëpia origjinale u shkatërrua nga zjarri. Ajo është e modeluar sipas shtëpive gjirokastrite tradicionale, duke marrë shumë nga elementet kulturore klasike. Nga viti 1966 deri në vitin 1991 ndërtesat shërbyen si Muzeu i Luftës Nacional Çlirimtare. Në vitin 1991 në këtë hapësirë u transferua Muzeu Etnografik.

3.3.2 Berati

Qendra Muzeore (QM) Berat

Qendra Muzeore Berat është institucion i specializuar dhe arkivor me status “muze kombëtar” në vartësi të Ministrisë së Kulturës me seli në qytetin e Beratit e cila administron “Muzeun Ikonografik Onufri dhe Muzeu Etnografik.

Muzeu i Ikonografisë Onufri është organizuar në ambjentet e kishës katedrale “Fjetja e Shën Marisë”, në Kalanë e Beratit, prej 27 shkurtit të vitit 1986. Muzeu mban emrin “Onufri”, kushtuar kryemjeshtrit të pikturës ikonografike shqiptare në shekullin e XVI.

Muzeu Etnografik ndodhet në zonën e mbrojtur shumë pranë qendrës historike (lagjeve Mangalem, Kala). Ai është përshtatur në vitin 1979 në një banesë tradicionale të qytetit, me dy kate me çardak në një krah, ndërtuar në fillim të shek XVIII.

⁸ Riza, Emin; “Qyteti muze i Beratit, arritje dhe perspektiva”; Monumentet 1990 /2



4. PROJEKTE NË PROCES

Nr.	PROJEKTET NË PROCES FSHZH	BASIKIA	FINANCUAR / PROGRAMI
1	Ndërtimi i bypassit në qendrën historike të Gjirokastrës (Ura e Nanxës-Urat e Mëdha Dunavat)	Gjirokastrë	Buxheti i Shtetit - GOA
2	Ndërtimi i godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse në Gjirokastrë	Gjirokastrë	Buxheti i Shtetit - IVR
3	Rehabilitimi i rrugëve me kalldrëm të pazarit	Gjirokastrë	PIUTD
4	Përmirësimi Urban i Integruar i Qytetit Muze të Gjirokastrës	Gjirokastrë	PIUTD
5	Sistemi i Muzeve - Gjirokastra	Gjirokastrë	PIUTD
6	Identifikimi, hartimi i masave prioritare për të adresuar shqetësimet urgjente të sigurisë dhe parandalimin e humbjes së strukturave të trashëgimisë në Kalanë e Gjirokastrës	Gjirokastrë	PIUTD
7	Asistencë teknike - Koncepti, Projektimi dhe Mbikëqyrja Përmirësimi Urban i Gjirokastrës (linja 7)	Gjirokastrë	PIUTD
8	Asistencë teknike - Plani i Lëvizshmërisë dhe Projektimi - Projektit të Investimit për Përmirësimin e Integruar Urban të Gjirokastrës	Gjirokastrë	PIUTD
9	Asistencë teknike - Masterplani i Menaxhimit të Qendrës dhe Valorizimit të Turizmit të Kalasë së Gjirokastrës (projekti)	Gjirokastrë	PIUTD
10	Rikualifikim Urban i Unazës së re.	Berat	Buxheti i Shtetit - GOA
11	Ndërtimi i godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse në Berat	Berat	Buxheti i Shtetit - IVR
12	Rehabilitimi i rrugës me kalldrëm "Mihal Komneno" deri në kalanë e Beratit	Berat	PIUTD
13	Përmirësimi i rrugës hyrëse të automjeteve "Muzak Topia" në kalanë e Beratit	Berat	PIUTD
14	Përmirësimi urban i integruar i Berat-(paketa 1-15)	Berat	PIUTD
15	Përmirësimi urban i integruar i Berat-Paketa 1-Goricë	Berat	PIUTD
16	Qyteti i Përmirësimit të Integruar Urban Berat - Paketa 02 (Antipatrea + Iliaz Vrioni&Zvërnec Bënja)	Berat	PIUTD
17	Qyteti i Përmirësimit të Integruar Urban Berat - Muzeu Etnografik dhe Paketa Mihal Komneno 03 (Selamlleku)	Berat	PIUTD
18	Asistencë teknike - Koncepti, Dizajni i Përmirësimit Urban të Integruar Berat dhe Përmjet (linja 12 dhe 14)	Berat	PIUTD
19	Përmirësimi i potencialit të Turizmit Kulturor nëpërmjet ndërhyrjeve në Kalanë e Beratit	Berat	TLED
20	Rritja e ofertës turistike të zonave natyrore në qarkun e Beratit, duke përmirësuar aksesueshmërinë dhe infrastrukturën e turizmit të aventurës, në zonat e parkut të Tomorrit dhe luginës së lumit Osun. Sistemi i muzeve dhe atraksioneve turistike, në zonat Historike të Beratit	Berat	TLED

5. NEVOJA PËR PMI

Plani i parë i menaxhimit është hartuar me objekt Qendrën Historike Gjirokastrë në vitin 2005, në kuadër të procesit të hartimit të dosjes së shpalljes Pasuri Botërore.

Në vitin 2008, përsëri në kuadër të procesit të hartimit të dosjes së shpalljes Pasuri Botërore në Seri, duke përfshirë dhe Qendrën Historike Berat, u hartua Plani i Menaxhimit i Integruar (PMI) për të dy qendrat historike. Ky i fundit ishte një plan menaxhimi 5-vjeçar, që u përgatit nga bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet autoriteteve vendore dhe institucioneve të trashëgimisë me asistencë teknike të ofruar nga Zyra e UNESCO-s në Venecia. Ky plan i parë i menaxhimit të integruar dha njohuri në lidhje me karaktere të ndryshme të nënzonave brenda Zonës së Mbrojtur, por ai nuk arriti të kalonte hapat e nevojshëm të miratimit nga institucionet kombëtare dhe madje



dhe nga Këshillat bashkiakë të të dy qyteteve. Megjithatë ishte një referencë e rëndësishme për institucionet e trashëgimisë (kombëtare dhe rajonale) për sa i përket çështjeve të nënzhonimit të zonave të mbrojtura dhe kriteret e diferencuara për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre. Rregulloret aktuale të të dy Qendrave Historike bazohen në parimet kryesore të paraqitura në këtë PMI.

Gjatë vitit 2012, Bashkia Berat mori pjesë si partner në programin SUSCULT i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe që përfshin disa Trashëgimi Botërore në nënrajonin e Evropës juglindore). Si rezultat i këtij programi Bashkia Berat përgatiti një Plan Menaxhimi për Qendrën Historike të Beratit, duke vijuar në shembullin e PMI-së së parë pothuajse i skaduar. Edhe pse ky plan i ri për Beratin ishte një hap pozitiv, ai nuk përfshiu Qendrën Historike Gjirokastrë dhe si i tillë nuk mund të konsiderohej një Plan Menaxhimi i Integruar.

Nevoja për një Plan Menaxhimi të përditësuar dhe të integruar ka qenë vazhdimisht e përmendur në të gjitha vendimet e Komitetit të Trashëgimisë Botërore (KTB) pas vitit 2012. Në vitin 2012, Misioni i Monitorimit Reaktiv ICOMOS që vizitoi Qendrat Historike vuri në dukje se: «*dy qytetet historike të Beratit dhe Gjirokastrës nuk menaxhohen si një pronë e vetme*». Si rezultat i këtij raporti nëpërmjet Vendimit 37 COM 7B.70 pikës 5, KTB i kërkoi Shtetit Palë që: «*të vendosë sa më shpejt që e mundur një strukturë gjithëpërfshirëse menaxhimi për pronën që ka përgjegjësi monitorimin dhe përshtatjen e ndërtimeve pa leje dhe për sigurimin e barazisë së qasjeve menaxhiuese të vlerave të trashëgimisë në të gjithë pasurinë botërore*».

Gjithashtu, në vitin 2015, Vendimi 39.COM 7B.75, pika 4, i kërkoi Shtetit Palë: «*Zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës të integruar menaxhimit, duke përfshirë një komponent për menaxhimin e riskut për zbutjen e kërcënimeve të fatkeqësive natyrore dhe / ose të shkaktuara nga njeriu*», Vendimi i Komitetit të Trashëgimisë Botërore i vitit 2017, nr. 41 COM 7B.40 kujton: «*Nevojën themelore dhe urgjente për një Plan gjithëpërfshirës të Menaxhimit të Integruar (PMI) dhe mekanizmat e duhur të kontrollit për Qendrat historike dhe zonat e mbrojtura, shpreh keqardhjen që, pavarësisht kërkesave të përsëritura, nuk është raportuar përparim në zhvillimin e një PMI-je të tillë për këtë pronë dhe i kërkoi Shtetit Palë që të zhvillojë, si çështje prioritare, një PMI gjithëpërfshirëse, duke përfshirë një komponent për menaxhimin e riskut për zbutjen e kërcënimeve të fatkeqësive natyrore dhe / ose të shkaktuara nga njeriu, si dhe për zhvillimin i një mjeti të integruar të konservimit dhe zhvillimit urban, bazuar në një rilevim të detajuar dhe dokumentim të të gjitha ndërtesave dhe veçorive mjedisore në zonën historike urbane dhe kontekstin e saj më të gjerë, duke përdorur nëse është e nevojshme qasjen e Rekomandimit mbi Peizazhin Historik Urban (2011), dhe për të siguruar bashkëpunimin ndër-institucional në veçanti me subjektet përgjegjëse për zhvillimin urban».*

Instituti i Monumenteve të Kulturës në vitet 2015 dhe 2018 ka përfituar asistencë teknike ndërkombëtare për:

1. Zhvillim e Trajnesve të Monitorimit për Qendrat Historike të Gjirokastrës dhe Beratit
2. Kursin e trajnimit rajonal «Përgjigje emergjente ndaj trashëgimisë kulturore në rrezik për qendrat historike të Gjirokastrës dhe Beratit, pasuri botërore» i zbatuar nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim e Evropës Juglindore në vitin 2018.

Në kuadrin e vendimeve të vazhdueshme të Komitetit të Trashëgimisë Botërore, në lidhje me nevojën urgjente të një Plan Menaxhimi të Integruar - PMI për Pronën Pasuri Botërore "Qendrat Historike të Gjirokastrës dhe Beratit", nga ana e IKTK-së në vitin 2017 u aplikua nëpërmjet programit për asistencë ndërkombëtare me financim të UNESCO-s. Asistenca Ndërkombëtare Nr. 2932 mbi "Zhvillimin e Planit të menaxhimit të integruar për Qendrat Historike Berat – Gjirokastrë" u miratua nga Qendra e Trashëgimisë Botërore (QTB) në vitin 2019.

Gjatë periudhës 2020-2022 IKTK-ja dakordësi me Qendrën e Trashëgimisë Botërore, termat e një asistence me vlerë 30,460.00 \$ me procesin e PMI në fokus dhe ka firmosur kontratën përkatëse me këtë të fundit në vitin 2021, duke hapur rrugë fillimit të procesit të konsultimeve me palët e interesit, grumbullimit dhe përpunimit të informacionit fillestar. Një draft fillestar i PMI iu



nënshtua në shkurt të vitit 2023 QTB-së dhe organeve të saj këshillimore se bashku me anekset përkatëse. Mbi bazën e këtij drafti, ICOMOS dhe ICCROM kanë përgatitur një sërë rekomandimesh që do të jenë pjesë e paketës me informacion udhëzues për procesin e rifilluar të PMI.

Vendimi i vitit 2024 të Komitetit të Trashëgimisë Botërore, nr. 46 COM 7B.2 rikonfirmoi nevojën emergjente për të vijuar me procesin e hartimit të PMI nisur në 2022 deri në hartimin e një drafti parapërfundimtar dhe shqyrtimin e tij nga Qendra e Trashëgimisë Botërore dhe organet e saj këshillimore, si një parakusht për asistencë të mëtejshme.

6. DETYRA

6.1 Qëllimi dhe objektivat

Në përputhje me çështjet kyce të identifikuara në vijim të këtij dokumenti, qëllimi kryesor i procesit do të jetë hartimi i një Plani Menaxhimi të Integruar për Qendrat Historike të Gjirokastrës, dhe Beratit pasuri botërore në seri.

Procesi do të udhëhiqet nga këto objektiva kyçe:

- Mbrojtja e vlerave të spikatura universale, e integritetit dhe e autenticitetit të Qendrave Historike të Beratit dhe Gjirokastrës.
- Zhvillimi i PMI-je bazuar në një analizë të detajuar të gjendjes ekzistuese dhe të vlerave të trashëgimisë kulturore.
- Përdorimi i qasjes së Rekomandimit mbi Peizazhin Historik Urban (2011).
- Krijimi i një sistemi qeverisjeje (governance) që përcakton rolet, përgjegjësitë dhe mekanizmat e koordinimit mes palëve të ndryshme të interesit.
- Promovimi i turizmit të qëndrueshëm dhe i zhvillimit të larmishëm ekonomik lokalisht, dhe për të cilët përfitues kryesorë janë bashkësitë vendase.
- Përfshirja e komponenteve të menaxhimit të riskut nga fatkqesive natyrore dhe/ose ato të shkaktuara nga njeriu, si dhe të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.
- Bashkërendimi i strategjive ekzistuese mbi potenciale dhe ose menaxhimit të rrezeve lidhur me zhvillimin urban, zhvillimin turistik, zhvillimin ekonomik e shoqëror, si dhe rrezeqet që lidhen me degradimin mjedisor dhe ndryshimet klimatike.
- Fuqizimi i bashkëpunimit ndër-institucional nëpërmjet konsultimit të të gjithë palëve të interesit duke përfshirë komunitetet lokale, shoqërinë civile dhe partnerët vendas e ndërkombëtarë.
- Analizë e zhvillimeve sociale dhe ekonomike brenda qendrave historike si dhe qyteteve të Beratit dhe Gjirokastrës dhe përpunimi i strategjive për harmonizimin e mëtejshëm të këtyre zhvillimeve me Vlerat e Jashtëzakonshme Universale të pasurive botërore.
- Evidentimi mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale dhe nevojave të komuniteteve, i ndërhyrjeve prioritare për sigurimin e vazhdimësisë së strukturës shoqërore brenda qendrave historike, përtej fukioneve me karakter turistik.

6.2 Çështjet kyçe


Zhvillimet dhe ndryshimet shoqërore të dekadave të fundit kanë bërë që Qendrat Historike të Beratit dhe Gjirokastrës të përballen me një sërë çështjesh që PMI duhet të adresojë në tërësi. Çështjet nuk kanë të bëjnë me site specifike brenda Qendrave Historike, apo procese të vecanta brenda sistemit ekzistues të menaxhimit. Përkundrazi ato kërkojnë të identifikojnë ide dhe linja konkrete përmirësimi brenda kuadrit ekzistues. Gjithashtu ato nuk nënkuptojnë që nuk ka asnjë përpjekje aktualisht për të menaxhuar dhe përmirësuar problematikat e identifikuar, thjesht nënvizojnë faktin që dhe më shumë punë është e nevojshme në këtë drejtim. Së fundimi, renditja e çështjeve nuk është tregues i asnjë sistemi priorizimi të tyre. Ndër ato më të rëndësishmet mund të renditen:

- 1- Nevoja për një sistem menaxhimi të përgjithshëm, të mirë-artikulluar dhe të përkthyer në instrumente efektive planifikimi dhe menaxhimi të zhvillimit të qëndrueshëm të Qendrave Historike të Beratit dhe Gjirokastrës, dhe që ka në fokus mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të spikatura universale të tyre.
- 2- Nevoja për në sistem qeverisjeje (governance) që bashkërendon dhe vendos në sinergji të plotë rolet, përgjegjësitë, mandatet dhe aspiratat e të gjitha palëve kyçe të interesit në raport me menaxhimin e Qendrave Historike Berat dhe Gjirokastrës.
- 3- Nevoja për të harmonizuar politikat e zhvillit të qëndrueshëm urban dhe turistik dhe ndërhyrjet që ato gjenerojnë *in situ* me prioritetin e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së vlerave të spikatura universale të Qendrave Historike.
- 4- Nevoja për të balancuar zhvillimin e vrullshëm të turizmit në Qendrat Historike Berat dhe Gjirokastrës, duke minimizuar eksternalitetet negative tek kushtet bazë të jetesës për komunitetet lokale që jetojnë në këto zona, dhe duke diversifikuar mundësitë e zhvillimit për këto të fundit.
- 5- Nevoja për të dokumentuar, analizuar dhe priorizuar zgjidhje afatgjata në raport me ndryshimet demografike, dhe pasjoat e tyre në funksionimin e Qendrave Historike, ku jetojnë dhe ushtrojnë aktivitetet e tyre komunitetet lokale.
- 6- Nevoja për krijimin e strategjive dhe instrumenteve efektive për përballjen me rreziqet e katastrofave natyrore apo me origjinë njerëzore si dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
- 7- Nevoja për një menaxhim koherent dhe proaktiv të vizitorëve, i cili nuk cënon vlerat e spikatura universale dhe kontribuon në qëndrueshmërinë e Qendrave Historike.
- 8- Nevoja për të konceptuar dhe menaxhuar në mënyrë të integruar dhe të qëndrueshme, sisteme transporti dhe parkimi për nevojat e banorëve rezidentë dhe të vizitorëve, dhe që ruajnë njëkohësisht integritetin historik e kulturor të Qendrave Historike të Beratit dhe Gjirokastrës.
- 9- Nevoja për ti kthyer Qendrat Historike në platforma aktive edukimi, hulumtimi dhe përfshirjeje me dhe përmes trashëgimisë kulturore të një game sa më të gjerë të njerëzve.
- 10- Nevoja për të forcuar qasjen dhe përfshirjen e palëve të interesit, me komunitetet vendore më në vecanti, në proceset e planifikimit, menaxhimit dhe ruajtjes së vlerave të spikatura universale të Qendrave Historike të Beratit dhe Gjirokastrës.
- 11- Nevoja për të evidentuar ndikimin kumulativ të të gjitha ndërhyrjeve të realizuara gjatë viteve të fundit në raport me Vlerat e Jahstëzakonshme Universale.

6.3 Produkti final

Produkti final

Produkti final i procesit do të jetë:



1) Plani i Menaxhimit të Integruar për Qendrat Historike Berat dhe Gjirokastrë

Dorëzimet

Në kuadër të procesit të hartimit të PMI, ekipi i përzgjedhur do të zhvillojë dorëzimet e mëposhtme:

Dorëzimet	Pëmbajtja
1. Raporti fillestar	Raporti fillestar do të përmbajë - Një vlerësim paraprak të gjendjes së tanishme përfshi këtu edhe draftin e parë të përcjellë dhe komentet e ICOMOS dhe ICCROM. - Një pasqyrë të sfidave dhe rreziqeve në duke marrë për bazë me çështjet kyçe të identifikuar [Pika 6.2], duke përfshirë kuadrin aktual të menaxhimit të Qendrave Historike, kufizime apo nevojat për përmirësim të kuadrit ligjor dhe rregullativ, perceptimin publik të masave që mund të propozohen, nevoja dhe çështje të tjera kyçe për adresim nga PMI, etj. - Një strategji të qartë të përfshirjes së grupeve të interesit. Një fokus të veçantë në këtë strategji do të ketë mobilizimi dhe përfshirja aktorëve në terren në Berat dhe Gjirokastrë, por jo vetëm, dhe ose të përfshirë në menaxhimin në përditshmëri të Qendrave Historike. - Një plan pune, ku do të përcaktohen qartë, ndër të tjera dhe: - Kalendari i detajuar i zbatimit të procesit të PMI dhe përgatitjet për dorëzimet përkatëse. - Plani i detajuar për mobilizimin dhe përfshirjen <i>Dorëzimi 1 do të qubet i përfunduar me konfirmimin e institucioneve përkatëse (IKTK/MEKI).</i>
2. Draft i parë i PMI	Drafti i parë i plotë, sipas specifikimeve të këtij dokumenti, kuadrin ligjor në fuqi e standarteve të aplikueshme. Dokumenti duhet të përfshijë në analizën e gjendjes aktuale të qendrave historike Berat dhe Gjirokastrë, një fokus të veçantë I cili do t'i kushtohet evidentimit të ndikimit kumulativ të të gjitha ndërhyrjeve të realizuara që nga Plani i fundit i Menaxhimit, në raport me Gjendjen e konservimit, integritetin dhe autenticitetin e qendrave historike Berat dhe Gjirokastrë. Kjo analizë do të detajohet në përputhje me rekomandimet dhe kërkesat e UNESCO-s në një shtojcë të posacme të PMI. <i>Dorëzimi 2 do të qubet i përfunduar me konfirmimin e institucioneve përkatëse (IKTK/MEKI).</i>
3. Drafti Parapërfundimtar	Drafti parapërfundimtar do të shërbejë si bazë për informim dhe konsultim me Qendrën e Trashëgimisë Botërore dhe organet e saj këshillimore, me qëllim reflektimin e rekomandimeve të mundshme në versionin final. <i>Dorëzimi 3 do të qubet i përfunduar me konfirmimin e institucioneve përkatëse (IKTK/MEKI) dhe QTB.</i>
4. Versioni final	Versioni final, për miratim në instancat përkatëse. <i>Dorëzimi 4 do të qubet i përfunduar me shqyrtimin dhe miratimin në KKTKM dhe QTB.</i>

6.4 Metodologjia

Ky proces do të zhvillohet nga ekipi i përzgjedhur në bashkëpunim me IKTK- e cila përpos koordinimit dhe monitorimit, do të sigurojë ndërlidhjen e nevojshme me Qendrën e Trashëgimisë Botërore UNESCO-s, në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e Trashëgimisë Botërore, si dhe në bazë të Legjislacionit Shqiptar për Trashëgiminë Kulturore.

Metodologjia që do ndiqet për hartimin e planit do të mbështetet mbi përvojat më të mira nga vendi, praktikat më të mira ndërkombëtare dhe rekomandimet e trupave këshillimore të UNESCO-s duke përfshirë Rekomandimin mbi Peizazhin Historik Urban (2011), si dhe mbi parimet e mëposhtme:

- Përfshirje e palëve të interesit dhe shoqërisë civile
- Fuqizimi i kapaciteteve vendore dhe i komuniteteve lokale për proceset e menaxhimit dhe administrimit të pasurisë
- Integrimi i komponentit të riskut në dokumentin e PMI-së
- Integrimi i konceptit të interpretimit në dokumentin e PMI-së
- Përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit midis institucioneve përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore në të dy Qendrat Historike me qëllim përcaktimin e veprimeve të përbashkëta në përputhje me statusin ndërkombëtar të UNESCO-s “Trashëgimi botërore në seri”.
- Plan i veprimit do të shoqërohet me indikatorë të matshëm e qartësisht të lidhura me qëllimet dhe me veprimet konkrete të propozuar nga PMI. Indikatorët e Monitorimit të realizuar në kuadër të Asistencës Ndërkombëtare të UNESCO-s 2015 do të shërbejnë si bazë e mirë për të hartuar listën e përditësuar të indikatorëve të monitorimit.

PMI do të zhvillohet për një periudhë kohore 7-vjeçare 2025-2032, duke pasur qasje bazuar në vlerat e pasurisë, në përputhje me ligjin 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 45 dhe 46.

Metodologjia e propozuar duhet të bazohet në referencë me praktikat më të mira ndërkombëtare për Site të Trashëgimisë Kulturore të ngjashme si dhe duhet të jetë në përputhje me VKM nr.169, datë 20.2.2020 “Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”.

Për përgatitjen e PMI do të merren në konsideratë dhe dokumentacioni i mëposhtëm nga UNESCO, përkatësisht:

VENDIMET E KOMITETIT TE TRASHEGIMISE BOTERORE

- 2024 - 46COM 7B.2 - Historic Centres of Berat and Gjirokastra (Albania) (C 569bis)
- 2023 - 45COM 7B.51 - Historic Centres of Berat and Gjirokastra (Albania) (C 569bis)
- 2021 - 44COM 7B.151 - Historic Centres of Berat and Gjirokastra (Albania) (C 569bis)
- 2019 - 43COM 7B.79 - Historic Centres of Berat and Gjirokastra (Albania) (C 569bis)
- 2018 - 42COM 13 - International Assistance
- 2017 - 41COM 7B.40 - Historic Centres of Berat and Gjirokastra (Albania) (C 569bis)
- 2015 - 39COM 7B.75 - Historic Centres of Berat and Gjirokastra (Albania) (C 569bis)
- 2013 - 37COM 7B.70 - Historic Centres of Berat and Gjirokastra (Albania) (C 569bis)

RAPORTET NGA MISIONET E QTB & ORGANEVE KËSHILLIMORE:

- 2022 - Report on the Joint EHC/ICOMOS/ICCROM Reactive Monitoring Mission to the World Heritage Property “HISTORIC CENTRES OF BERAT AND GJIROKASTRA” 13-17 December 2021



2016 - Report on the ICOMOS Advisory Mission to Historic Centres of Berat and Gjirokastra (Albania) (C 569bis), 27-29 April 2016

2012 - Report on the Reactive Monitoring Mission to the Historic Centres of Berat and Gjirokastra (Albania), 10-14 November 2012

REKOMANDIMET E ORGANEVE KESHILLIMORE MBI PROCESIN E NISUR TE PMI
Raportet nga ICOMOS dhe ICCROM dhe ICOMOS, përkatësisht në datat 15 dhe 16 Mars 2023

Struktura e planit të menaxhimit përmban, por pa u kufizuar, kapitujt si më poshtë:

- a) përmbledhja ekzekutive;
- b) hyrja;
- c) përshkrimi e pasurisë kulturore;
- ç) vlerësimi i vlerave të pasurisë;
- d) aspekte të tjera të lidhura me pasurinë;
- dh) vizioni, qëllimi e objektivat;
- e) administrimi i pasurisë kulturore;
- ë) plani i veprimit;
- f) zbatimi dhe monitorimi;
- g) Hartat dhe shtojcat.

6.5 Gjuha

Përmbajtja e të gjithë dorëzimeve të PMI parashikuara në pikën 6.3 do të jenë në dy gjuhë: në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Përkthimet do të realizohen përmes përkthyesve të licencuar nga konsulenti.

6.6 Periudha e zbatimit të procesit të PMI


Kohëzgjatja e të gjithë procesit është 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, për të mundësuar kohën dhe resurset e mjaftueshme për konsultime dhe mbledhjen e reagimeve nga palët e interesit. Ofertuesit mund të propozojnë kalendarin e tyre të procesit në fjalë, por në asnjë rast nuk mund të tejkalohet kohështiraj maksimale e procesit prej 12 muajsh.

Periudha e pritshme e fillimit të procesit është Dhjetor 2024.


6.7 Kualifikimet minimal të nevojshme

Tabela e mëposhtme liston kualifikimet minimale të nevojshme për formimin e ekipit të ekspertëve të ngarkuar me procesin e PMI.

Nr.	Pozicioni	Fusha e ekspertizës	Kualifikimet minimale
-----	-----------	---------------------	-----------------------



1	Udhëheqës(e) ekipi, vendas ose ndërkombëtar(e)	Ekspert(e) i (e) menaxhimit të trashëgimisë kulturore	Edukimi: - Diplomë e avancuar universitare (minimalisht Master ose ekuivalent) në menaxhimin e trashëgimisë kulturore, zhvillimin socio-ekonomik, peizazhin kulturor, zhvillim urban, dhe të fusha të tjera të ngjashme Kualifikimi: - Eksperience 20 vjetare me site të ngjashme në rajonin e Mesdheut - Eksperiencë të dëshmuar në drejtim ekipi në të paktën 2 plane të ngjashme menaxhimi të integruar përsëri të ngjashme UNESCO - Përvoja me projekte të ngjashme në fushën e menaxhimit të trashëgimisë kulturore në Shqipëri konsiderohen si një avantazh.
2	Ekspert(e), Vendas(e) ose ndërkombëtar(e)	Ekspert(e) i (e) sistemeve të qeverisjes (governance)	Edukimi: - Diplomë e avancuar universitare (minimalisht Master ose ekuivalent) në administrim publik, shkencë politike, shkencë sociale, shkencë juridike dhe të fusha të tjera të ngjashme. Kualifikimi: - Eksperiencë 10 vjetare me procese të ngjashme mobilizimi, koordinimi dhe vendimarrjeje me palët të ndryshme interesi. - Përvoja me projekte të ngjashme në fushën e menaxhimit të trashëgimisë kulturore në Shqipëri konsiderohet si një avantazh.
3	Ekspert(e), Vendas(e) ose ndërkombëtar(e)	Ekspert(e) i (e) menaxhimit të riskut	Edukimi: - Diplomë e avancuar universitare (minimalisht master ose ekuivalent) në menaxhimin e riskut, menaxhimin e fatkeqësive dhe emergjencash, shkencë mjedisore, dhe të fusha të tjera të ngjashme. Kualifikimi: - Eksperience 10 vjetare me procese të ngjashme të analizimit, identifikimit, dhe propozimit të masave zbutëse. - Përvoja me projekte të ngjashme në fushën e menaxhimit të trashëgimisë kulturore në Shqipëri konsiderohet si një avantazh.
4	Ekspert(e) vendas(e)	Ekspert(e) i (e) trashëgimisë lokale	Edukimi: - Diplomë e avancuar universitare (minimalisht master ose ekuivalent) në arkitekturë, planifikim urban, inxhinier, pejsazhe historike dhe/ose kulturore, dhe të fusha të tjera të ngjashme. Kualifikimi: - Eksperiencë 10 vjetare me trashëgiminë lokale, arkitekturën vernakulare, planifikimin urban në kontestin e qendrave historike.



			• Ekspertizë të dëshmuar lokale të dy siteve Berat dhe Gjirokastrë, të vërtetuar me botime dhe/ose eksperience pune. • Të jetë i/e pajisur me licensat P.A1, P.A2, P.A3, P.A5, P.A6, P.A7.
5	Ekspert(e), Vendas(e) ose ndërkombëtar(e)	Ekspert(e) i(e) turizmit të qëndrueshëm	Edukimi: • Diplomë e avancuar universitare (minimalisht master ose ekuivalent) në zhvillim të turizmit, turizëm kulturor, menaxhim të trashëgimisë kulturore, dhe fusha të tjera të ngjashme. Kualifikimi: • Eksperience 10 vjecare me procese të ngjashme në qendra historike në vend dhe jashtë. • Përvojë e dëshmuar në zhvillim të strategjive të turizmit të qëndrueshëm në të paktën një sit të ngjashëm UNESCO.
6	Ekspert(e), Vendas(e) ose ndërkombëtar(e)	Ekspert(e) i(e) demografisë	Edukimi: • Diplomë e avancuar universitare (minimalisht master ose ekuivalent) në demografi, sociologji, gjeografi, shkencë sociale dhe fusha të tjera të ngjashme. Kualifikimi: • Eksperience 10 vjecare me procese të ngjashme në qendra historike në vend dhe jashtë. • Përvojë e dëshmuar në zhvillim të strategjive, studimeve mbi ndryshimet demografike dhe impaktin përkatës.
7	Specialistë mbështetës	Specialistë mbështetës • Specialist(e) i(e) angazhimit të komunitetit • 2 Specialistë të konservimit arkitektonik + 1 arkeolog • Specialist(e) i(e) mjedisit • Specialist(e) i(e) mobilitetit • Specialist(e) i(e) ekonomisë • Specialist(e) ligjor(e)	

Ofertuesit mund të propozojnë ekspertë dhe/ose specialistë mbështetës shtesë, duke argumentuar propozimin. IKTK do të kërkojë garanci që ekspertët/specialistët e propozuar do të jenë efektivisht të angazhuar në proces. Cdo ndryshim i ekspertëve/specialistëve të propozuar, do të bëhet vetëm nëse do të sigurohet minimalisht i njëjti nivel ekspertize me emrin e zëvendësuar, dhe vetëm pas miratimit me shkrim nga IKTK.

7 BIBLIOGRAFI

1. Faqe zyrtare e UNESCO-s, <https://ehc.unesco.org/en/list/569>
2. Riza, Emin; "Qyteti muze i Beratit, arritje dhe perspektiva"; Monumentet 1990 /2
3. Udhëzues për menaxhimin e Trashëgimisë kulturore botërore. Bernard M. Fielden , Jukka Jokilehto

4. Doempke S., Lulo A., Petrela S.; “Katër qytete historike në Ballkanin Jugperëndimor”; GCDO; Tiranë; 2012
5. Baçe, Apollon; “Qyteti i fortifikuar i Beratit”; Monumentet 1971/2
6. Riza, Emin; “Qyteti muze i Beratit, arritje dhe perspektiva”; Monumentet 1990 /2
7. Riza, Emin; “Banesa e fortifikuar Gjirokastrite”; Monumentet 1971/1

8 LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1	Zonifikimi i Qendrës Historike Berat – VKM Nr.827 date 28.12.2023
Shtojca 2	Zonifikimi i Qendrës Historike Gjirokastrë – VKM Nr.764 date 20.12.2023
Shtojca 3	Rekomandimet nga ICOMOS, mbi procesin e PMI realizuar nga IKTK, 2020-22
Shtojca 4	Rekomandimet nga ICCROM mbi procesin e PMI realizuar nga IKTK, 2020-22
Shtojca 5	Lista e Monumenteve, Gjirokastrë
Shtojca 6	Lista e Monumenteve, Berat

Harto: Joli Mitrojorgji

